



## DREJTORIA E ARSIMIT

Nr. 05 - 38  
Podujevë,

29.01.2020

Bazuar në nenet 7 dhe 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 të Republikës së Kosovës, Ligjit mbi Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës nr. 04/L-032, Ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës nr. 03/L-068, Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, i datës 19.10.2017, Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 10/2018 për normativ mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, i datës 20/07/2018, Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 05/2015, Normativ për mësimdhënësit e arsimit profesional, si dhe kërkesave e nevojave për plotësimin e vendeve të lira të punës për mësimdhënësit të shkollave fillore dhe të mesme të Komunës së Podujevës, Drejtoria e Arsimit, shpall:

### KONKURS

#### edukatore në SHFMU “ Shaban Shala “

#### 1. Një (1) mësimdhënësit të programit parashkollor

- Kriteret e kualifikimit:

- 2.1 Fakulteti i Edukimit – Programi parashkollor;
- 2.2 Shkolla e Lartë Pedagogjike – drejtimi për edukatore
- 2.3 Fakulteti Filozofik – dega e pedagogjisë së përgjithshme
- 2.4 Fakulteti i Shkencave Sociale- programi përkujdesja dhe mirëqenia e fëmijëve

#### KUSHTET:

##### I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit (i cili merret dhe dorëzohet në qendrën për shërbime të qytetarëve);
- Certifikata e lindjes;
- Dokumentin personal – letërnjoftimi ose pasaporta (kopje);

- Dëshmi mbi kualifikimin (kopja e vërtetuar);
- Certifikatat e trajnimeve të akredituara nga MASHT;
- Dëshmi mbi përvojën e punës (nëse keni);
- Certifikatën që nuk jeni në hetime;
- Certifikatën e mjekut (vetëm kandidatët të cilët pranohen në marrëdhënie pune, pra pas publikimit të rezultateve).
- **Sqarim shtesë:**
  - Informatat e dhëna në aplikacion konsiderohen të vlefshme vetëm nëse dëshmohen me dokumente;
  - Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet t'i kenë të nostrifikuara dokumentet në MASHT;
  - Në test/intervistë ftohen kandidatët që i plotësojnë kriteret e konkursit sipas U. A. (MASHT) nr. 10/2018 për normativ mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, i datës 20/07/2018, por në mungesë të kuadrit adekuat mund të ftohen edhe kandidatët me kualifikim të përafërt;
  - Testi/intervista me kandidatë për mësimdhënës mbahet në Qendrën për ngritje profesionale në objektin e SHFMU "Shaban Shala", Podujevë, kati II, sipas orarit të intervistimit i cili do të publikohet me kohë në tabelën e shpalljeve të Komunës së Podujevës (në hyrje të objektit të komunës),
  - Me këtë konkurs zhvillohen procedurat e rekrutimit për vendin e punës edukatore.
  - Në rast të ndonjë nevoje eventuale për mësimdhënës/e në IEAA, do të bëhen angazhime sipas renditjes së listave pritëse;
  - Dokumentet nuk kthehen.
- **Afati i konkursit**

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, në tabelën e shpalljeve në objektin e komunës dhe në ueb-faqen e Komunës së Podujevës: <http://kk.rks-gov.net/podujeve>, pra deri më datë 13.02.2020.

**drejtori**  
**Agim Blakçori**

